

AKT - THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE

**“ZGARA TE ÇUNAT” SHPK**

SELIA HIMARE

MARS 2022

STATUT

I

SHOQERISE TREGTARE

**“ZGARA TE ÇUNAT” SHPK**

SELIA HIMARE

MARS 2022

**AKT - THEMELIMI  
PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ZGARA TE ÇUNAT ” SHPK**

Sot me date 17.03.2022 , ditën e **enjte** , Z.Eraldo Avdulaj , i datelindjes 14.06.1995 lindur ne Sarande ,mbajtes i leternjoftimit me personal nr. J50614066I dhe Z.Amarildo Bushaj , i datelidnjes 04.01.1985, lindur ne Fier , mbajte i leternjoftimit me personal nr. I50104018P , me iniciativen tone te lire si dhe duke u bazuar ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise , Kodin Civil ne fuqi , ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare”, ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te regjistrimit « , ligji nr.10475, date 27.10.2011 "Per disa ndryshime ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligji nr.129 2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "te ndryshuar , ligji nr.110/2012 "Per bashkimin nderkufitar te shoqerive tregtare". si dhe , ate Doganor , Fiskal , Tatimor, me ndryshimet perkatese, vendosem te krijojme shoqerine shqiptare me pergjegjesi te kufizuar per sa me poshte vijon :

**Neni 1  
EMERTIMI I SHOQERISE**

Te formohet shoqeria tregtare shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin  
**“ Zgara Te Çunat ” sh.p.k.**

**Neni 2  
KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

Shoqeria , krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pakufizuar, mbi dhjete vjete pune te njepasnjeshme.

Ky afat mund te shkurtohet per rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe do te pasqyrohen ne Statut.

**Neni 3  
QENDRA E SHOQERISE**

Shoqeria **“ Zgara Te Çunat ” SHPK**, do te kete qendren ( seline ) e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise , ne adresen : Rrethi Vlore , Bashkia Himare Rr. Jorgji Bollano , Godine dykateshe, nr53 Himare .

**Neni 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

**Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj tregtar ne keto drejtime :**

**Shoqëria tregëtare private “ Zgara Te Çunat ” sh.p.k., ka për objekt të veprimtarisë së saj:**

Bar, Bufë ,shebime te zgares ,shebime ‘Delivery ‘

**Neni 5  
REGJIMI JURIDIK**

Ne te gjithë territorin e saj ne Republikën e Shqiperise Shoqeria do te udhehiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakeve te saj percaktohen me hollesisht ne Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.

Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi,dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit ,sic shprehohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislativës në fuqi .

#### **Neni 6**

#### **ORTAKU THEMELUES**

Themelues i shoqërisë është ortakë Eraldo Avdulaj me 50 (pesdhjetë) % pjesëmarrje në përqindje, dhe ortakë Amarildo Bushaj, me 50 (pesdhjetë) % pjesëmarrje në përqindje të kuotave të shoqërisë.

#### **Neni 7**

#### **KAPITALI I SHOQËRISË**

7/1 Kapitali bazë i Shoqërisë është në para: 100.000 (njëqind mijë) leke, ortakë Eraldo Avdulaj , me 50 (pesdhjetë) % pjesëmarrje në përqindje, dhe Amarildo Bushaj, me 50 (pesdhjetë) % pjesëmarrje në përqindje të kuotave të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të paguhet mbas regjistrimit të kësaj shoqërie në QKB.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrazi të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themelues të shoqërisë;

7/2 Kapitali i shoqërisë do të rritet krahas ecësive të ekonomisë , financiare si dhe të vendimeve që do të marrin ortakët e shoqërisë për ta rritur ato në të ardhmen

7/3 Pjesët e kapitalit themelues janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie , në rast ndarje pasurore mes bashkeshortëve dhe nepërmjet paraardhësve e pasardhësve sipas legjislativës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

7/4 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakëve të shoqërisë .

Ky fitim do të disponohet lirish prej tyre , në bazë të raportit të kontributit të tyre në kapitalin themelues, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve dhe të jenë hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1\10 të kapitalit të shoqërisë .

#### **Neni 8**

#### **DREJTIMI I SHOQËRISË**

8 Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është mbledhja e ortakëve.

8/1 Asambleja e ortakëve, merr vendime të zakonshme ose të jashtë zakonshme sipas disponimeve të statutit të shoqërisë .

8/2 Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj Z.Eraldo Avdulaj, me atësi Astrit, i datelindjes 14.06.1995, lindur në Sarandë, mbajtes i letërnjoftimit me personal nr.J50614066I, i cili do të ketë detyrë për një periudhë 5 (pese) vjetore, me të drejtë rizgjedhje .

Administratori e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

8/3 Për çdo çështje profesionale, si juridike, ekonomike, teknike etj , shoqëria do të angazhojë sipas rastit në mënyrë të vijueshme ose të perkoheshme duke përdorur specialist sipas legjislativës në fuqi .

#### **Neni 9**

#### **SIGURIMI I PASURISË SE SHOQËRISË**

9/1 Pasuria e shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës si dhe në institute të tjera private ekzistuese apo që do të krijohen në të ardhmen sipas legjislativës në fuqi .

9/2 Masa e pasurisë që do të sigurohet si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga Administratori .

#### **Neni 10**

#### **MBYLLJA EKONOMIKE VJETORE E SHOQËRISË**

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllën më 31 dhjetor të çdo viti.

Përfundimi nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

#### **Neni 11**

#### **LIKUJTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

**Neni 12**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

- 12/1 Ky akt per themelimin e Shoqerise ka si pjese te saj edhe Statutin e Shoqerise i cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- 12/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise , sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruar edhe ky Akt - Themelimi .
- 12/3 Adresa ligjore e shoqerise eshte : Vlore , Bashkia Himare Rr. Jorgji Bollano , Godine dykateshe, nr53 Himare .
- 12/4 Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim ,te nenshkruhet nga ortaket e saj dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj,ashtu edhe ne QKB perkatese .
- 12/5 Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim , do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën kompetente Shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .
- Ky Akt Themelimi i shoqerise u printua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga une ortaku i vetem i saj me vullnet te lire dhe te plote .

**ORTAKET E SHOQERISE**

Eraldo Avdulaj 

Amarildo Bushi 

**STATUTI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ Zgara Te Çunat ” sh.p.k.**

**I. Krijimi, forma, emertimi , Objekti , selia dhe kohezgjatja e shoqerise .**

**Neni 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ **Zgara Te Çunat** ” sh.p.k. eshte krijuar sipas Aktit te Themelimit qe i bashkelidhet ky Statut i perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket e kesaj shoqerise, per sa me poshte vijon :

**Z.Eraldo Avdulaj** , i datelindjes 14.06.1995 lindur ne Sarande ,mbajtes i leternjofimit me personal nr. J50614066I dhe **Z.Amarildo Bushi**, i datelidnjes 04.01.1985, lindur ne Fier , mbajte i leternjofimit me personal nr. I50104018P



## Neni 2

Shoqëria zhvillon veprimtarione tregtare në Shqipëri në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e këtij statuti. Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj .

## Neni 3

**Emertimi i shoqërisë është “ Zgara Te Çunat ” sh.p.k.**

## Neni 4

**Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto drejtime :**

**Shoqëria tregëtare private ” Zgara Te Çunat ” sh.p.k., ka për objekt të veprimtarisë së saj:**

Bar, Bufë ,shebime të zgarës ,shebime ‘Delivery ‘

## Neni 5

Shoqëria “ **Zgara Te Çunat** ” SHPK, do të ketë qendren ( seline ) e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë , në adresën : Rrethi Vlorë , Bashkia Himarë Rr. Jorgji Bollano , Godinë dykateshe, nr53 Himarë .

Shoqëria, mund të hapë filiale të saj në të gjitha rrethet e vendit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi .

## Neni 6

Shoqëria “ **Zgara Te Çunat** ” SHPK, krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pakufizuar , mbi dhjetë vjetë pune të njëpasnjëshme . Ky afat mund të shkurtohet për rastet kur shoqëria do të shpërbehet sipas përcaktimeve që do të pasqyrohen në Statut.

## II . Kapitali themeltar , Kontributi , pjesët e kapitalit themeltar .

### Neni 7

Kapitali baze i Shoqërisë është në para: 100.000 (njëqind mijë) leke, ortaku Eraldo Avdulaj , me 50 (pesdhjetë ) % pjesëmarrje në përqindje, dhe Amarildo Bushaj, me 50 (pesdhjetë) % pjesëmarrje në përqindje të kuotave të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve është në para dhe do të paguhet mbas regjistrimit të kësaj shoqërie në QKB.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë perkundrejt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

7/2 Kapitali i shoqërisë do të rritet krahas ecurisë së saj ekonomike , financiare si dhe të vendimeve që do të marrin ortakët e shoqërisë për ta rritur atë në të ardhmen

7/3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie , në rast ndarje pasurore mes bashkeshortëve dhe nepermjet paraardhësve e pasardhësve sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

7/4 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakeve të shoqërisë .

Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre , në baze të raportit të kontributit të tyre në kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tremeve dhe të jenë hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1\10 të kapitalit të shoqërisë .

## Neni 8

**III Organet drejtuese të shoqërisë , Marrja e vendimeve , Administrimi , kompetenca dhe kontrolli i shoqërisë .**

8 Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është mbleasambleja e ortakeve.

8/1 Asambleja e ortakeve, merr vendime të zakonshme ose të jashtë zakonshme sipas disponimeve të statutit të shoqërisë .

2 Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj Z.Eraldo Avdulaj, me atësi Astrit, i datelindjes 14.06.1995, lindur në Sarandë, mbajtes i letërnjoftimit me personal nr.J50614066I, i cili do të ketë detyrë për një periudhë 5 (pese) vjetecare, me të drejtë rizgjedhje .

Administratori e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tremeve, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë.

8/3 Per cdo ceshtje profesionale, si juridike, ekonomike, teknike etj , shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialist sipas legjislacionit ne fuqi .

### Neni 9

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqerise apo te treteve , per shkelje te ligjeve, te dispozitave te ketij statuti, apo per faje gjate administrimit te shoqerise .

### NENI 10

Disa nga kompetencat qe i jepen Administratorit jane :

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakut i vetem,
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut te vetem për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoje përpara ortakut te vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### NENI 11

#### MBLEDHET E ASAMBLESE

**Mbledhja e Asamblese,** jane te zakonshme dhe te jashtezakonshme

Mbledhjet e ortakut te vetem , te zakonshme duhet te thirren te pakten nje here ne vit .

### NENI 12

1-Asambleja e e pergjithshme thirret nepermjete nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjete postes elektronike i cili duhet te permbaje vendin , daten , oren e mbledhjes dhe rendin e dites e i dergohet ortakëve jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese .


2-Kur Asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakorte per te marre vendime , panvaresisht parregullsise .

Administratori emerone nje sekretar per mbajtjen e procesverbalit .

Me autorizimin me shkrim te nenshkruar nga ortakët, shoqerine mund ta perfaqesoje cdo person tjetër .

### NENI 13

**Asambleja e ortakëve te shoqerise,** eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :



- a- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b- ndryshimin e statutit
- c- emerimin e shkarkimin e administratorit ose administratoreve
- d- emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- e- percaktimin e shperblimeve per personat e permenduar ne shkronjat « c » dhe « d » te kesaj pike .
- f- mbikqyrjen dhe zbatimin e politikave tragtare nga administratori apo administratoreve , perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- h- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i- pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j- perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit, apo administratoreve.
- k- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l- miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve se ortakut te vetem.
- m- ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji .
- n- Ben pranimin e anetareve te rinj te shoqerise .

#### NENI 14 LIBRAT E SHOQERISE

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pavec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere dhe keto libra :

- 1- Libri i ortakut ne te cilin shenohen emtri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar .
- 2- Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit vendimor .
- 3- Libri i Mbledhjeve dhe vendimeve te organit adminstrativ .

#### IV , Viti Financiar dhe llogarite vjetore NENI 15

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik .

#### NENI 16

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe cdo raport tjetër i veçantë në këtë drejtim, te hartuara nga Administratori , nga eksperti kontabel pas shqyrtimit i paraqiten për miratim ortakeve të shoqërisë brenda tre muajve dhe në çdo rast, jo më vonë se tre muaj nga data e mbylljes së vitit. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes .

#### NENI 17

17/1 Veprimtaria ekonomike – financiare dhe tregtare e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë .

17/2 Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregetar dhe juridik me persona te trete shoqeria pergjigjet me pasurite e veta .

17/3 Aktivi dhe pasivi i veprimtarise se Shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike – financiare dhe tregtare te saj te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj .

17/4 Pasurite e shoqerise vleresohen nepermjet bilanceve ekonomiko- financiare dhe tregtare te saj ,ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi .

17/5 Te ardhurat e shoqerise pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se palujteshme dhe te luajteshme si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interes te shoqerise ,i takojne ortakeve te shoqerise sipas dispozitave te percaktuara ne aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj .



17/6 Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ajo I mbulon nga fondi rezerve ose nga shumat suplementare. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te .

17/7 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionitne fuqi .

17/8 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administratori I shoqerise .

#### **Neni 18**

Mjetet e investuara për themelimin e shoqërisë si dhe ato të shtuara nga aktiviteti i saj i zgjeruar regjistrohen në librin afarist të shoqërisë menjëherë. Shoqëria është pronare, përdoruese, disponuese e pasurive në emër të vet në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

### **V . Dividentet**

#### **NENI 19**

Pas mbarimit te llogarive vjetore dhe te evidentimit te ekzistences se fitimit ,percaktohet pjesa qe iu takon ortakut themelues ne formen e dividendit mbi fitimin . Ky fitim perbehet nga : fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin e lene rezerve te domosdoshem te percaktuar nga ortaket ,te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjetere jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme .

#### **Neni 20**

Pasuritë e shoqërisë vlerësohen me bilancet e saj, me vlera të shprehura në monedhë shqiptare dhe të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të zbatuara në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me të huaj dhe e kundërta bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka në momentin e këmbimit të saj.

### **VI. Punësimet ne shoqeri**

#### **Neni 21**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës, e cila mund të jetë kolektive dhe individuale. Çështjet të cilat nuk gjejnë rregullim në kontratat e punës zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar: Kodi i Punës dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që ka të bëjë me këtë çështje.

#### **Neni 22**

I punësuari nuk merr pjesë në ndarjen e fitimit të cilin e realizon shoqëria gjatë veprimtarisë së saj apo edhe në humbjet e saj, nëse në kontratën e punës nuk është përcaktuar ndryshe.

Ai përgjigjet materialisht për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj.

### **VII . Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë.**


#### **Neni 23**

Shoqeria prishet para kohe kur :

1. Aktiviteti ekonomik i saj per disa vjet radhazi eshte ne humbje .
2. Per arsye te parashikuara ne ligj .
3. Veprimi i kushteve te forcave madhore .
4. Dalja e nje vendimi nga Organet kompetente qe ndalon veprimtarine e saj .

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit të saj qysh në momentin e prishjes ose të shpërbërjes.

Per kryerjen e ketij procesi ortaket caktojne nje ose disa likujdues te cilet i paraqesin asamblese raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasurive te shoqerise ,mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatet e nevojshme te perfundimit te tyre .



Ne fund te procesit te likujdimit ortaku i vetem, vend mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit .

Pas pagimit te kreditoreve dhe te shlyerjes, kapitali themeltar kontribues dhe gjithë kapitali finaciar e material i mbetuar , i kalon ortakut te vetem .

### **XIII . Zgjidhja e mosmarreshjeve** **Neni 24**

Zgjidhja e mosmareveshjeve qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim ,e nese kjo nuk arrihet atehere pala e interesuar mund ti drejtohet organeve kompetente te juridiksionit te vendit ku kane lindur mosmarreshjet .

### **IX. Dispozita te pergjithshme** **Neni 25**

Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje, dekrete, ose vendoset nje politike me e favoreshme nga legjislacioni i pasqyruar ne Aktin dhe Statutin e krijimit te Shoqerise atehere ortaku i shoqerise ka te drejten t'u drejtohet organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem per shoqerine e krijuar .

### **X . Dispozita te vecanta** **Neni 26**

26/1 Te gjitha dokumentat e shoqerise do te permbajne adresen e plote te saj ,numrin e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar te QKB , Numrin Unik te Identifikimit per ushtrimin e veprimtarine e saj .

26/2 Per ceshtje te tilla qe nuk parashikohen ne Statut ,veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

### **HYRJA NE FUQI** **Neni 27**

27/1 Ky Statut i perpiluar nga ne ortakët ne 4 ( kater ) kopje te barabarta , hyn ne fuqi qysh ne momentin e nenshkrimimit nga ana jone .

27/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtare te shoqerise ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruari edhe ky Statut i saj .

27/3 Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit tregetar , si dhe te ecurise se veprimtarise se shoqerise, ortaku i vetem ka te drejten e permiresimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij Statuti dhe te te gjithë dokumentave te Shoqerise duke bere depozitimet perkatese sipas legjilacionit ne fuqi .

### **ORTAKET E SHOQERISE**

Eraldo Avdulaj



Amarildo Bushi

